



Lajmet e Fundit:

Tiranë – Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “Universi”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e vjedhjes së pronës dhe pasurisë

⏏ ⏪ ⏩



14/03/2022

Fast Albania – Finalizohet operacioni policor ndërkombëtar i koduar “Valencia”

Vijon bashkëpunimi i ngushtë i strukturave të Policisë së Shtetit me homologët, për kapjen e personave të shpallur në kërkim ndërkombëtar.

Finalizohet operacioni policor ndërkombëtar i koduar “Valencia”.

Operacioni u realizua nga Fast Albania në bashkëpunim të ngushtë me Fast Spain dhe me Interpolin e të dy vendeve.

Kapen dy vëllezër, të shpallur në kërkim ndërkombëtar për vrasje të mbetur në tentativë.

Falë bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit në kohë, ndërmjet FAST Albania dhe FAST Spain për vendndodhjen e dy vëllezërve në kërkim, është organizuar dhe finalizuar operacioni policor ndërkombëtar i koduar “Valencia”.

Në kuadër të operacionit, në qytetin Valencia të Spanjës, bazuar në informacionet e dhëna nga Fast Albania, u bë e mundur kapja, nga Fast Spain, e dy vëllezërve të shpallur në kërkim ndërkombëtar, E. K., 37 vjeç dhe M. K., 41 vjeç, i cili përdorte një pasaportë të falsifikuar të Maqedonisë së Veriut.

Për të dy vëllezërit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Vrasje me dashje e kryer në bashkëpunim”, e mbetur në tentativë dhe “Prodhim e mbajtje pa leje të armëve e municioneve luftarake”.

Ky operacion tregoi rëndësinë e krijimit të strukturës policore Fast Albania, si dhe profesionalizmin dhe besueshmërinë e strukturave të Policisë së Shtetit për të vepruar si të barabartë me homologët.

🗨 Share

📘 Share

🐦 Share

📌 Share

✉ Email

◀ Tiranë – Finalizohet me sukses operacioni policor i koduar “White Van”, për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e narkotikëve

Raporti ditor i ngjarjeve, Policia e Shtetit, 15 mars 2022 ▶

Kërko

Enter a word for search 🔍

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Shërbimi Për Qështjet e Brendshme dhe Ankesat

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent